



Sinjale paralajmërimi mbi Sigurinë Kibernetike

Të cituara nga hakerët

► SINJAL 1

Potenciali i sulmeve kibernetike

84% e hakerëve besojnë se më pak se gjysma e kompanive në botë e kuptojnë rrezikun e vërtetë të sulmeve kibernetike.

Vetëm 2.5% e hakerëve besojnë se 75–100% e kompanive kuptojnë rrezikun e vërtetë .

► SINJAL 3

Testimi në kohë të përcaktuar

88% e hakerëve besojnë se testimi i sigurisë në kohë të përcaktuar nuk është i mjaftueshëm për t'i mbajtur kompanitë të sigurta gjatë gjithë vitit.

► SINJAL 5

Mungesa e një VDP (Vulnerability Disclosure Program)

Më shumë se gjysma e të gjithë hakerëve nuk kanë raportuar vulnerabilitete sepse kompania nuk dispononte një program të qartë raportimi, pa rrezikuar pasoja ligjore.

► SINJAL 2

Rritja e vulnerabiliteteve dhe kompleksitetit të tyre

84% e hakerëve besojnë se tani ka më shumë vulnerabilitete sesa në fillim të pandemisë.

75% e hakerëve besojnë se është rritur vështirësia e gjetjes së vulnerabiliteteve në asetet kritike.

► SINJAL 4


Privatësia vs. Ulja e kostos

Mbi një e treta e hakerëve besojnë se të paktën gjysma e kompanive në nivel global janë të gatshme të sakrifikojnë privatësinë dhe/ose sigurinë afatgjatë të klientëve të tyre për të ulur kostot në periudha afatshkurtra.

► SINJAL 6

Hapësirë e pamjaftueshme

Një e treta e hakerëve raportojnë se programet pa hapësirë të mjaftueshme fushëveprimi i ndalojnë ata të jenë të suksesshëm.



Sinjalet paralajmëruese janë praktika, qëndrime dhe tendenca në tregun e sigurisë, të cilët hakerët i cilësojnë si çështje shqetësuese. Identifikoni sinjalet tuaja paralajmëruese dhe konsideroni rezultatet më poshtë!

0-1 SINJALE

Keni arritur statusin e ekspertit kibernetik!

Përgëzime! Programi juaj i sigurisë është i avancuar dhe përpara shumë organizatave, por mos harroni se siguria është një udhëtim i vazhdueshëm.

2-4 SINJALE

Jo keq, por keni nevojë për përmirësime.

Keni përparuar shumë përsa i përket sigurisë tuaj kibernetike, por gjithçka që duhet është një dobësi kritike që të shkaktohen pasoja katastrofike.

Përdorni burime informacioni të ndryshme lidhur me sigurinë, për të forcuar përpjekjet tuaja.

5-6 SINJALE

Është koha për të ndryshuar ofruesin juaj të sigurisë

Mos u shqetësoni - mes hendekut të aftësive tuaj të sigurisë kibernetike dhe ndyshimit të vazhdueshëm të teknologjisë, është e vështirë të ndjekësh ritmin. Përdorni burime të shumta informacioni për të forcuar përpjekjet tuaja.